

Lidershipi përballë një bote në transformim

Reflektime të Linda Ramës mbi tranzicionin, kompleksitetin global dhe përgjegjësinë e atyre që drejtojnë

Bisedë e Linda Ramës me Laila Humairah në Qendrën për Lidership të Katarit.

Sesioni u organizua nga Qatar Leadership Centre në Doha, më 23 nëntor 2025, në kuadër të programit “Spotlight” për alumnët e qendrës.

Laila Humairah: Mirëmëngjesi të gjithëve. Faleminderit që u bashkuat me ne për këtë takim që përqendrohet posaçërisht tek lidershipi, zhvillimi social dhe vendimmarrja bazuar në të dhëna dhe sot, me ne, jemi shumë të nderuar që kemi shkëlqesinë e saj, znj. Linda Rama, ekonomiste e realizuar, aktiviste civile, studiuese me përvojë e ekonomisë sociale kombëtare, përkrahëse e globalizimit dhe e fuqizimit të gruas dhe shumë e shumë të tjera, lista vazhdon; edhe bashkëshortja e shkëlqesisë së Tij, Kryeministrit Edi Rama, i cili sapo ka përfunduar bashkëbisedimin e tij tek Universiteti “Georgetown” dhe na e kaloi stafetën neve, për të vazhduar me këtë bisedë rreth gjithçkaje që ka të bëjë me lidershipin. Shpresoj që do të zhvillojmë një bashkëbisedim të këndshëm rreth kësaj sot. Përpara se të nisim, dua të them gjithashtu se, nëse keni diçka, për të hapur diskutimet në fund – mund ta hapim për disa pyetje e përgjigje – kështu që, ndërsa ne diskutojmë, nëse keni ndonjë pyetje, mbajeni mend dhe, në fund, mund të krijojmë hapësirën për pyetje e përgjigje. Atëherë, pa vonesa të mëtejshme, si pjesë e këtij sesi për lidershipin, dua t’ju pyes si e përkufizoni lidershipin dhe ajo çka është më e rëndësishme, si do ta përkufizonit lidershipin efektiv e transformues në sferën e diplomacisë, sipërmarrjes, ndikimit social?

Linda Rama: Mirëmëngjesi. Jam vërtet e nderuar që gjendem këtu. E pranova me shumë kënaqësi ftesën për të ardhur këtu dhe për të ndarë me ju pikëpamjet dhe mendimet e mia. Lidershipi. Pikë së pari, mendoj që lidershipi lipset të përballët me të njëjtin kompleksitet të jetës që po jetojmë. Me kompleksitet dua të them se kohërat që po jeton bota sot janë shumë të veçanta, në kuptimin e përparimeve teknologjike. Kompanitë e mëdha të teknologjisë janë gjithmonë e më të pranishme në jetën tonë dhe, ndonjëherë, më shqetëson, sepse kanë monopolin mbi ne në një planet, që quhet icloud, për të cilin nuk dimë asgjë. Pra, ne iu dërgojmë vazhdimisht të dhëna dhe ata mund të hyjnë në jetët tona, çdo ditë, në çdo moment që duan. Ata mund të hyjnë në shtëpitë tona, falë pajisjeve. Mund të

hyjnë në vendet tona të punës, falë kompjuterëve. Mund të hyjnë brenda nesh, në trupat tanë, falë telefonave celularë. Lehtësisht. Në çdo moment. Pra, ky është një kompleksitet i madh, që lidhshipi duhet ta njohë e të përballet me të. Po jetojmë kohëra kur planeti po përjeton shumë trysni. Njerëzit po ushtrojnë shumë trysni mbi planetin. Dhe kjo ndodh sepse konsumizmi është në nivelet më të larta të mundshme, për shkak të ambicieve të njerëzve dhe ekuilibri midis asaj që duan njerëzit dhe asaj që vetë planeti do, që të jetë i sigurt, është në një farë mënyre në konflikt. Një tjetër dimension është biznesi. Po ta shihni, bizneset janë gjithnjë e më shumë të përfshira në ambicie që shkojnë përtej biznesit. Ky është një tjetër element kompleks, që i shtohet lidhshipit. Pra, si mund të përballet lidhshipi me këtë mjedis kaq kompleks? Ka edhe të tjerë faktorë kompleksë, si të drejtat e njeriut. Sot, ne kemi ngritur shumë pikëpyetje mbi të drejtat e njeriut dhe ka shumë raste kur të drejtat e njeriut po përjetojnë erozion krahasuar me më parë. Ka edhe shumë elementë të tjerë. Unë mendoj që, sigurisht, sot, më shumë se kurrë më parë, lidhshipi nuk supozohet vetëm të ofrojë për njerëzit. Së pari, iu duhet gjithashtu të mbajnë barrën për t'u vetë transformuar dhe reagues me shpejtësi ndaj kompleksitetit të botës, së bashku me njerëzit. Njerëzit ndryshojnë, ndaj edhe lidhshipi duhet të ndryshojë aq shumë sa të ndjejë këtë botë në ndryshim. Unë mendoj se transformimi tek njerëzit ndodh më lehtësisht sesa transformimi i lidhshipit. Kështu, unë besoj se liderat duhet të transformohen po aq shpejt sa bizneset, po aq shpejt sa njerëzit në jetën e tyre të përditshme dhe po ashtu me të njëjtin ritëm me të cilin e jetojnë transformimin të rinjtë.

Laila Humairah : Dhe si bëhet kjo? Kur flasim për sferën e teknologjisë, që do ndryshojë gjeopolitikën, si i shohin udhëheqësit e rinj gjithë këto ndryshime në botë dhe thonë, “si duhet të marr iniciativën dhe të them dua të jem lider e dëshiroj të sjell ndryshimin?” Këtë do ta lidh edhe me pyetjen tjetër, sepse dua të shkoj pas në kohë, në vitin 1992, kur përjetuat rënien e regjimit komunist dhe fillimin e një epoke të re politike për Shqipërinë. Si ishte ai moment për ju? Çfarë e ushqeui gjithë punën që bëtë vitet më pas?

Linda Rama: Në vitin 1990, ne ishim vendi i fundit në Evropën Lindore, Evropën Lindore Qendrore, që dolëm nga komunizmi. Pse ishim të fundit? Sigurisht që ishim të fundit, sepse ishim më të izoluarit. Asokohe, ishim Koreja e Veriut e Evropës, vendi më i izoluar në Evropë. Më kujtohen dy parulla, parullat kryesore që mbanin protestuesit. Njëra ishte, “liri, demokraci” dhe tjetra, “e duam Shqipërinë si gjithë Evropa”. Pra, ne ishim shumë të ndërgjegjshëm për atë që donim dhe për atë që nuk donim. Nuk donim komunizmin dhe, për këtë, ishim të

vendosur dhe donim që Evropa të ishte me ne dhe ishim të patundur për këtë. Ne donim liri, donim demokraci. E gjithë pjesa tjetër ishte e panjohur, krejt e panjohur dhe, më vonë, kuptova se nuk ishte e panjohur vetëm për ne – unë isha 26 vjeçe në atë kohë – por ishte e panjohur edhe për ata që na drejtonin dhe ishin lidërsipi i ri.

Në atë kohë nuk e dinim që ata ishin kaq të paditur për atë që po vinte. Mund ta dinin teorikisht, por, praktikisht, askush nuk e dinte çfarë do të thoshte për një vend komunist të dilte nga një sistem e të hynte një sistem krejt tjetër, që ishte e kundërta e tij. Kështu, tranzicioni na u përplas me të gjitha ato dukuri që na u desh t'i përballonin në jetën tonë të përditshme.

Më kujtohet që gjëja e parë që doja të dija ishte t'iu jepja përgjigje qindra, mijëra pyetjeve që më lindin në kokë dhe nuk merrja dot përgjigje rrotull meje. Shkoja nga një mjedis në tjetrin, dëgjoja lajmet. Dëgjoja, nuk di, kolegët e mi. Askush nuk më jepte dot përgjigje ndërsa thoja me vete si do të përballemi me këtë rrugë të jashtëzakonshme që shtrihet përpara?

Më pas, duket se pata intuitë mjaftueshëm, kurajë mjaftueshëm dhe fat mjaftueshëm, sepse shfrytëzova mundësinë e një burse që, në vitin 1992, të shkoja jashtë dhe të kryerja studimet e mia master. Pra, në vend që të vazhdoja të ngrija pyetje brenda vendit, shkova të dëgjoja diku tjetër, ku dinin përgjigje, në thelb dhe, kur u ktheva, diçka që e di me siguri është se sa herë ka kohë transformimesh të mëdha – atëherë ishte prej komunizmit, sot prej këtij kompleksiteti – udhëhiqesh nga ëndrrat, nuk udhëhiqesh nga dija. Dhe lidërsipi me ëndrra dhe pasion është shumë më e fortë sesa lidërsipi me dije, sepse, nëse ke ëndrra, je i hapur të shtosh dije, të marrësh mbështetje, të kërkosh ndihmë, të bësh gjithçka që është e nevojshme, për të mos hequr dorë nga ëndrrat, po për të vazhduar e për të ecur me to. Kjo është ajo çfarë kujtoj nga ajo kohë. Në të njëjtën kohë, ajo që më dha hov ishte pasioni që kisha për të parë ndryshimin. Edhe ndryshimet e vogla ishin shumë domethënëse për mua, sepse isha thjesht një njeri që donte të përmirësonte veten, të përmirësonte familjen e saj, lagjen e saj, por që, njëkohësisht, nuk e shkëpuste vëmendjen nga kauzat e përbashkëta shoqërore. Isha shumë e ndjeshme ndaj gjithçkaje që ndodhte rreth meje dhe e kam ruajtur me këmbëngulje këtë ndjeshmëri. Pra, dëshira për të realizuar ëndrrat dhe pasioni për të ecur përpara e për të përmirësuar gjërat

mendoj se ishte motivimi më i mirë për të vazhduar përpara dhe për t'u përmirësuar.

Laila Humairah: Përmendët disa nga sfidat këtu. A mund të flisni pak për sfidat e fëmijërisë së hershme, të fazave të hershme të karrierës suaj? Cilat ishin disa prej sfidave më të mëdha dhe si ua dolët?

Linda Rama : Kur kthehem pas tani, shoh që e gjithë jeta ime ka qenë e mbushur me sfida dhe jam shumë e lumtur për këtë. Ndiem kaq me fat për këtë. Për shembull, ndihem me shumë fat që kam jetuar në komunizëm. Është shumë paradoksale, sepse, normalisht, nëse i thua një të riu tani, tim biri, shko e jeto në komunizëm, në atë ferr, do të të kthehet, “ke luajtur gjë mendsh?” Dhe nuk dua që ai të jetojë në atë kohë, por, njëkohësisht, të jetoje me ato kufizime, pa liri, pa perspektiva, thjesht, izoluar në 28 000 metra katrorë, mund të bësh krahasimin dhe të vlerësosh atë që ke sot dhe mund ta shohësh vërtet shumë ndryshe botën nga dikush që e ka parë hapjen që prej ditës së parë.

Në fëmijëri, sfida ishte të bëheshe fëmijë i mirë, t'i bëje prindërit krenarë dhe të kënaqur me atë që bëje. Këto janë sfida me të cilat të gjithë përballen në vitet e para të jetës. Pas viteve '90, sfidat ishin shumë më të mëdha, sepse duhej të merresha në të njëjtën kohë me familjen, me fëmijën, pastaj me punën, profesionalisht me karrierën. Duhej të vrapoje e të vrapoje, që të mund të formoje identitetin tënd profesional dhe, njëkohësisht, të forcoje identitetin tënd personal, të tregoje veten në të gjitha mjediset dhe në cilësi të ndryshme dhe ta shihje se ishe e vlefshme për veten, për familjen dhe shoqërinë. Në fakt, ndër të gjitha sfida më e madhe me të cilën jam përballur ka qenë ajo e këtyre mbi 10 viteve të fundit kur Edi u bë Kryeministër. Është sfida më e madhe, sepse, kur je bashkëshortja e një udhëheqësi të lartë, një kryeministri, ka rrezik që menjëherë pas këtij momenti – madje pikërisht në atë moment, jo pas tij, në atë moment – të shndërrohesh vetëm në bashkëshorte dhe asgjë tjetër. Të gjithë të shohin si bashkëshortja e kryeministrit dhe çdo gjë tjetër që ekzistonte më parë rrezikon të fshihet. Është shumë e dhimbshme dhe shumë shqetësuese ta shohësh sa shpejt dhe sa lehtë ndodh kjo, ndërkohë që ke kaluar kaq shumë vështirësi ndër shumë vite për të ndërtuar identitetin tënd si njeri dhe si profesionist dhe ke investuar kaq shumë, jo vetëm unë, por edhe prindërit e mi kanë investuar shumë, gjyshërit e mi shumë, profesorët e mi, miqtë, të gjithë rreth meje, ndaj, si është e mundur që momenti që je bashkëshortja e kryeministrit, bëhet rreziku më i madh për ty,

momenti kur nuk je më askush, por vetëm bashkëshortja? Duhet shumë durim, shumë kuptim e mirëkuptim dhe qëndresë.

Qëndresa, më së shumti, duhet të jetë e heshtur, sepse nuk e ke privilegjin apo luksin ta bërtasësh, pjesa e zëshme duhet t'i përkasë bashkëshortit, i cili merret me çështje shumë më të vështira, me shumë më tepër kauza, që ndikojnë tek e gjithë popullsia dhe jo vetëm te popullsia në vend, por te shqiptarët kudo në botë. Pra, pjesa e zëshme i mbetet atij, dritat duhet të jenë tek ai dhe optika duhet të qëndrojë tek ai. Në të njëjtën kohë, sidoqoftë, duhet të gjesh mënyra t'iu tregosh njerëzve që ekziston, vazhdon, që je vetja, që ke identitetin tënd dhe je e vlerësuar, je mbështetje, je me ta, dhe jo thjeshtë me bashkëshortin tënd. Shumicën e herëve, i thua që unë jam me ju dhe jam një prej jush, e interesuar po njësoj si ju që bashkëshorti im të punojë mirë dhe kjo nuk është e lehtë. Ja pse kam ardhur në një pikë ku them dhe jam vërtet e sigurt për këtë se asnjë kryeministër në planet nuk mundet të bëjë rolin e bashkëshortes së kryeministrit. Është e pamundur. Ndaj, mendoj se vetëm bashkëshortet e kryeministrave e dinë çfarë do të thotë roli i tyre. Ndoshta, do të vijë një kohë ku do ta shtjelloj edhe më gjatë, të themi, këtë rol, por mendoj se është një sfidë e jashtëzakonshme, sepse të duhet të funksionosh në një dimension krejt tjetër.

Laila Humairah: Kjo, po ashtu, ripërkufizon atë thënien se pas çdo burri të suksesshëm qëndron një grua, por, në të njëjtën kohë, ju ecni me një hap bashkë me të, si parterë në jetë e në gjithçka tjetër. Dua të rimarr një nga gjërat që thatë më herët rreth rritjes në komunizëm dhe keni folur pak për këtë. Keni thënë që frika ishte ajo zamka që mbante shoqërinë së bashku në atë kohë. Tri dekada më tej dhe pas kaq shumë transformimi, cila është, sipas jush, zamka që mban shoqërinë të bashkuar tani, qoftë në Shqipëri apo kudo në botë. Cila është zamka që duhet ta mbajë bashkë shoqërinë?

Linda Rama: Besoj që, ne, shqiptarët, në tri dekada tranzicioni, jemi përballur me kaq shumë dukuri, kaq shumë vështirësi dhe ndryshime, sa që u krijua një peshë e caktuar për brezin tonë dhe brezin e prindërve tanë. Mendoj kjo është ajo që na mban së bashku gjatë këtyre tri dekadave. Mendoj se është pikërisht çështja sesi mund të ndahet kjo peshë, që ajo të mund të mbahet.

Në vendet që dalin nga këto përvoja traumatike, është e pamundur që shteti t'u përgjigjet ashtu si do të donte njëherësh të gjitha problemeve që ka shoqëria dhe

vendi. Ndaj, ndarja e disa prej përgjegjësive është shumë e rëndësishme dhe mendoj se shqiptarët kanë qenë në gjendje – dhe është e jashtëzakonshme ta shohësh si ndodh – të mbajnë peshën e tri dekadave tranzicioni, me një lloj solidariteti që është i jashtëzakonshëm ta shohësh. Kjo është gjëja e parë. E dyta është dëshira për ndryshim, për të kontribuar në ndryshim, në mënyrë që ta tejkalojmë si individë, si familje, si vend dhe shoqëri prapambetjen e së shkuarës. Kështu, këto përpjekje, ky ndryshim dinamik na bashkon. Më ka mahnitur dhe vazhdon të më mahnitë vendimi i njerëzve sesa shumë e ëndërrojnë anëtarësimin tonë në BE. Nëse shkon dhe i pyet shqiptarët tani, përqindja në favor të anëtarësimit në BE është mbi 90% dhe kjo ndodh kur vetë Evropa po vë në pikëpyetje të madhe arkitekturën e saj. Ne e duam ende, sepse e dimë çfarë është e kundërta. Nuk mendoj se evropianët, e kam fjalën ata në Bashkimin Evropian, e dinë për çfarë bëhet fjalë. Ne e dimë, sepse e dimë çfarë ishte komunizmi. Ja pse shqiptarët janë kaq të vendosur, sepse duan të korrigjojnë padrejtësinë që na bëri historia. Edi është tashmë në mandatin e katërt dhe një nga premtimet më të mëdha që bëri ishte anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian në vitin 2030 dhe mbylljen e bisedimeve për anëtarësim në vitin 2027. Dhe ishte e pabesueshme. Ai mori mbështetje maksimale krahasuar me tri mandatet e mëparshme.

Kjo ndodhi sepse vjen me peshë të jashtëzakonshme, ndodhi sepse shqiptarët e dinë që, nëse ndajmë përgjegjësitë për problemet e përditshme me qeverinë, pra, ne mbajmë tonat, ndërkohë që qeveria mban përgjegjësitë e saj, së bashku, qeveri dhe popull, kemi një përgjegjësi, ta bëjmë vendin tonë jo thjesht si Evropa, sepse ne jemi Evropë. Është paradoks, ne jemi Evropë, por nuk jemi ende në Evropë. Ky paradoks duhet të marrë fund. Ne duhet të jemi në Evropë, sepse jemi Evropë.

Laila Humairah: Kjo na çon te një prej pohimeve tuaja në fillim, kur brezi i viteve '90 e dinte çfarë donte e çfarë jo dhe kjo është pak a shumë njësoj me të njëjtën ndjenjë për anëtarësimin në BE. Dua t'i kthehem njërës prej gjërave që përmendët më parë, që trauma nga fëmijëria e hershme ju bëri luftëtare ose brezin tuaj i bëri luftëtarë për ndryshim shoqëror dhe ekonomik. Po si mund ta frymëzosh dhe formësosh brezin e ardhshëm të luftëtarëve të ndryshimit shoqëror dhe ekonomik kur ai rritet në një botë më të lirë, më të lehtë do thoja?

Linda Rama : Është shumë interesante, sepse ka 2000 vjet që brezi i të rriturve ankohet përherë për brezin e ri.

Përgjatë gjithë historisë, brezi i vjetër thoshte se brezi i ri nuk është gjëkundi. Janë dembelë. Nuk duan të punojnë. Nuk duan përgjegjësi. Nuk kanë rezultate. Ankohen e ankohen, e ankohen. Unë nuk i përkas kësaj kategorie. Ju e dini, unë kam fatin që kemi tre fëmijë; dy më mëdhenjtë që janë 36 dhe 35 vjeç dhe kemi më të voglin që është 11. Pra, në thelb, jemi prindër të dy brezave. Dy brezave të ndryshëm. E shohim ndryshimin që ka. Mendoj se duhet të bindemi se mjedisi është ndryshe dhe brezi është ndryshe. Nuk është brez më i mirë apo më i keq. Është i ndryshëm dhe duhet ta pranojmë. Për shembull, nëse detyra e brezit tonë dhe nuk po flas për Shqipërinë, po flas për botën ishte ta bënim botën më të mirë, më të përparuar – dhe besoj se mund të themi se bota sot është shumë më e përparuar dhe shumë më e mirë, krahasuar me 30, 40, 50 vjet më parë – detyra e këtij brezi është edhe më e vështirë, sipas meje. Është më e vështirë, sepse ne donim të arrinim atë që nuk kishim. Donim që bota të ishte më e madhe. Donim që të drejtat të ishin më mirë e më shumë, që harta e të drejtave të përhapej në botë. Detyra e këtij brezi është të mbajë, të ruajë atë që ne arritëm dhe ta çojnë më përpara. Ata e dinë si do ta bëjnë, por ne e dimë që janë të mirëpajisur për ta bërë këtë.

Investimet që bëhen sot në arsimim kudo janë të jashtëzakonshme. Kapacitetet ose mjetet që po i jep brezit të ri përparimi teknologjik dhe digjitalizimi, për të kontrolluar apo marrë në zotërim gjëra që, me burokracitë tona, duheshin javë e vite për t'u bërë, ata i bëjnë në kohë reale dhe sasia e të dhënave që prodhohen sot, ndërkohë që, për ne, të dhënat ishin problemi më i madh, është e pabesueshme. Pra, si mund të bëhen luftëtarë me gjithçka që kemi krijuar për ta, bizneset, politikanët, njerëzit, prindërit, gjyshërit. Atyre iu duhet të luftojnë për një ose disa rreziqe që hasin. Atyre nuk iu pëlqen të dëgjojnë. Nuk ndalen të dëgjojnë. Ata duhet të krijojnë aftësinë për t'u ndalur sepse, të ndalesh është vlerë dhe të jep kohë të reflektosh dhe reflektimi duhet, edhe kur mendon se i di gjërat. Jo, mund të mos i dish, ndaj vënia e vetes në pikëpyetje është një talent i madh dhe me këtë talent mund të arrish shumë. Pra, ajo me të cilën do të përballen ata tani është krejt e ndryshme nga e jona. Ne kishim shumë kohë të ndaleshim dhe të mendonim. Ata nuk e kanë këtë kohë të ndalen e të mendojnë, ndaj iu duhet ta krijojnë aftësinë për t'u ndalur e për të menduar. Po ta dëgjosh këtë në brezin tim, tingëllon paradoksale, por është e vërtetë. Ndaj, atyre iu duhet të ndërtojnë aftësitë që kishim ne në hapësira të mëdha në kohe ose që i kemi

ende. Në të ardhmen, ritmi do të jetë shumë, shumë më i shpejtë, kështu që duhet ta frenojnë pak veten.

Laila Humairah: Të kuptojnë dhe të veprojnë mirëfilli me fuqinë e ndalesës dhe reflektimit. Dua ta vazhdoj sërish. Përmendëm të dhënat masive në fillim dhe tani në përgjigjen tuaj. Ju keni nxjerrë dhjetëra botime mbi ndryshimin civil, çështjet socialekonomike. Në thelb të të gjithë kësaj janë kërkimi dhe të dhënat. Si shkoni përtej numrave, për t'i bërë njerëzore këto të dhëna me të cilat punon, që pastaj t'i kthesh në politika dhe, më tej, si nxiten liderat për t'i kthyer politikat në veprim efektiv?

Linda Rama: E dyta është shumë më e vështirë, që lidershpi të marri informacionin dhe të dhënat dhe t'i kthejë në veprime efektive. Ajo çfarë kam deri diku... Më lini t'ju tregoj një histori. Deri në vitin 1998, punoja për qeverinë. Isha në krye të privatizimeve. Isha shumë e re, por ndodhi që më besuan reformën më të rëndësishme në vend, ndoshta sepse erdha nga jashtë, me shumë njohuri si duheshin trajtuar reforma të tilla kaq të vështira.

Në vitin 1998, ndala së punuari për qeverinë dhe jepja mësim në universitet. Pra, isha edhe akademike, dhe studiuese. Merresha me një sërë projektesh ndërkombëtare asokohe, me rrjete të tjera që studionin çështjet e tranzicionit. Studimet e mia deri në vitin 1998 ishin thellësisht ekonomike, pra, ekonometri e nuk di, vetëm studime ekonomike dhe kaq. Më pas, në vitin 1998, kur nuk punoja më për qeverinë, thashë “po tani çfarë do të bëj?” Dhe mendoj që ishte një nga vendimet më të rëndësishme që kam marrë, vendimi i duhur.

Ndërsa punoja për privatizimin, kisha kontakt me shumë grupe të ndryshme njerëzish. Kisha mundësi të takohesha me ish-të persekutuar dhe në të gjitha historitë e tyre, pashë deri diku tërë jetën e tyre në kohët shumë të ashpra të komunizmit. Takova ish-pronarë që donin të rimerrnin të drejtat e pronësisë mbi pasuri që iu ishin konfiskuar gjatë periudhës komuniste. Takova investues të rinj. Deri në vitin 1990, investimet private nuk lejoheshin, ndaj gjithçka vinte prej sipërmarrësve të rinj. Pata, po ashtu, mundësi të shihja për herë të parë investues të huaj që trokitnin në derë, sepse ishin të interesuar të blinin pasuri. Më tej, shihja punëtorë që dilnin nga puna, për shkak se nuk kishte punë dhe prej falimentimit të ndërmarrjet shtetërore, duke sjellë mjaft dukuri, si varfëria dhe vendimet për të emigruar. Ishte një lloj kaosi nga pikëpamja shoqërore. I thashë

vetes, “nëse vazhdoj vetëm me ekonominë, me shifrat ekonomike dhe shoh vetëm si ecën ekonomia, do humbas çfarë është kryesore, sepse ekonomia mund të ecë mirë, por mund të mos shkojë në përfitim të të gjitha grupeve të ndryshme të njerëzve. Kështu, drejtësia është shumë e rëndësishme dhe çështjet sociale janë po aq të rëndësishme, ndaj, në atë moment, thashë që duhet të merrem me këtë dimension njerëzor, krah të gjitha studimeve ekonomike që bëj. Ja pse themluam Qendrën për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor, e cila ishte një instrument që ne të kryenim kërkime, por, në të njëjtën kohë, të jepnim rekomandime mbi ato çfarë duhej të përmirësohej në të gjitha aspektet, ekonomike, shoqërore dhe në aspektin e drejtësisë në shoqëri. Me këtë, dua të them që, ndonjëherë, kishim shifra kombëtare që nuk na thonin asgjë dhe thoshim: “Jo, këto nuk e tregojnë historinë. Duhet ta shohim historinë në fytyrat e njerëzve”. Kështu, zbritëm në komunitete dhe pamë realitetin dhe vendosëm teknikat tona në këto realitete, për të gjetur shifrat. Me këto shifra, që plotësonin shifrat kombëtare, ishim në gjendje të prodhonim rekomandime shumë më të mira për politikën.

Kur bëhet fjalë për politikëbërësit, ata kanë rolin më të vështirë. Por, nga ana tjetër, kanë edhe mundësinë më të madhe. Nuk mund ta imagjinoni – dhe e them nga këndvështrimi i dikujt që merret me të dhënat, jam shumë xhelozë për këtë – sasinë e të dhënave që kanë në duar politikanët. Gjithfarëlloj të dhënash. Thjesht të kenë dëshirë të kërkojnë të dhëna dhe t’i përdorin ato. Nëse ata nuk dinë ç’të bëjnë, nuk e imagjinoni sa shumë njerëz, më të mirët, mund t’i thërrasin që t’i këshillojnë brenda dhe jashtë vendit. Pra, do të mjaftonte vullneti nga ana e tyre për të mobilizuar mendjet më të mira, që të marrin vendimet më të mira.

Problemi më i madh që mendoj se kanë politikanët, udhëheqësit, është të gjejnë burimet për të realizuar politikën e duhura, efektive. Me burime, e kam fjalën si për burimet njerëzore, që janë shumë të rëndësishme, ashtu edhe ato financiare. Te burimet financiare, udhëheqësit më efektivë për mua janë ata që nuk mbështeten fillimisht te burimet publike, por janë të aftë të mbledhim maksimumin e burimeve rreth tyre, ndihmë private, të huaja, investime të huaja, në mënyrë që të gjitha këto të kombinuara të vihen në dispozicion të objektivave të zhvillimit, duke i sjellë shoqërisë përfitime në të tashmen, por edhe duke menduar për të ardhmen.

Laila Humairah : Dua të cek diçka që ka të bëjë me mbështetjen në të dhëna, por që lidhet me lidhshëpin dhe me zhvillimin e talenteve të reja, sepse Shqipëria ka një prej normave më të larta të së ashtuquajturës “rrjedhje e trurit”, me një numër të madh

talentesh të reja, të cilat largohen nga vendi dhe nuk kthehen më realisht ose nuk duan të kthehen. Një nga sfidat më të mëdha – në fakt, vetë mbajtja e talenteve më vete është sfidë e madhe për çdo vend – por mbajtja e talenteve të reja është posaçërisht me rëndësi për zhvillimin kombëtar të çdo vendi në botë. Si mund t'i mbajë Shqipëria të rinjtë e talentuar, që të mos ikin jashtë dhe ndoshta të mos duan të kthehen? Ashtu si ju, ju shkuat jashtë dhe u kthyet për të kontribuar në mënyra të jashtëzakonshme. Dua të marr mendimin tuaj për këtë, për rrjedhjen e trurit.

Linda Rama: Së pari, do doja shumë të riformuloja përkufizimin e rrjedhjes së trurit në realitetin tonë. Në realitetin tonë, rrjedhja e trurit është edhe kthim i trurit, sepse imagjinojeni një vend plotësisht të izoluar dhe imagjinoni që popullsia prej 3 milionësh të kishte mbetur aty në vitin 1990. Vetëm imagjinojeni çfarë do të kishte ndodhur nëse njerëz si unë nuk do të kishin ikur jashtë të studionin apo të tjerë të punonin. Mendoj që ky skenar do ishte shumë, shumë i rëndë. Ajo çfarë po them me këtë është se kemi dëshmuar vazhdimisht se rrjedhja e trurit është fitim i trurit për vendin, ndërkohë, pasi njerëzit ikën jashtë, disa prej tyre, si unë, u kthyem në vend. Më lini t'ju jap një shembull. Unë u largova nga vendi në vitin 1992 dhe u ktheva, pra jam një emigrante e rikthyer. Vajza jonë shkoi të studionte jashtë dhe u kthye. Ajo është një e rikthyer gjithashtu. Ishte jashtë për shumë vjet, ndaj mund të konsiderohet si dikush që u largua nga vendi, ikje e turit, por në fakt, u kthye përsëri. Edi ishte në Francë, përpara se të kthehej e të bëhej ministër Kulture, në vitin 1998. Gregu, djali ynë, u largua për dy a tre vjet për të studiuar jashtë. U kthye. Dhëndri im punonte në Gjermani. Ai ka studiuar e punuar në Gjermani për, nuk di, rreth tetë vjet. U rikthye dhjetë vjet më parë, përpara se të martohej me vajzën tonë. Vëllai im qëndroi për 10 vjet në Greqi, deri në vitin 2000, dhe u rikthye.

Pra, po të shohësh familjet në vend, ka shumë njerëz të tillë. Nga njëra anë, kishte ikje të trurit, po, nga ana tjetër, pjesë e tyre u kthyen, me më shumë dije, më shumë përvojë dhe nisën ta vinin brenda vendit në jetë këtë eksperiencë. Ndaj, nuk ka një vijë të prerë ndarëse në kohërat ku jetojmë midis rrjedhjes dhe kthimit të trurit.

Sigurisht, duhet t'i kushtojmë shumë vëmendje si t'i mbajmë të rinjtë; të bëjmë dy gjëra. Së pari, të mbajmë talentet e reja në vend. Së dyti, të gjejmë mënyrat si t'i përdorim në maksimum, në këtë botë ku jetojmë, ata që janë jashtë vendit. Puna në distancë, komunikimi me anë të internetit dhe të gjitha këto mjete duhen

përdorur, duke marrë parasysh që shqiptarët po ecin mjaft mirë në shumë e shumë fusha kudo gjenden në botë dhe ne duhet t'i sjellim më afër vendit, edhe nëse vendosin të qëndrojnë jashtë.

Kjo është një detyrë shumë e vështirë, por e pajisur me të gjitha mjetet që kemi në dispozicion. Në fakt, shqiptarët e kanë provuar se i ruajnë shumë lidhjet me vendin. Ja pse mendoj që është edhe kjo meritë ajo që na ka çuar aq afër dyerve të Bashkimit Evropian.

Laila Humairah: Shumë mirë që u përmend globalizimi, sepse ju jeni një përkrahëse e madhe globalizimit. Sidoqoftë, në të njëjtën kohë shohim trazira në shumë anë të botës: proteksionizëm në rritje, nacionalizëm dhe shtim i ndasive shoqërore, po ashtu. Kur shohim gjithë këto gjëra që ndodhin në mbarë botën, si të vazhdojmë t'i besojmë ende te fuqisë së globalizimit?

Linda Rama : Po të hedhësh sytë këtu, e kam fjalën për Katarin, nuk mundesh veçse të besosh te fuqia e globalizimit dhe, për ata që kanë dyshime, do t'iu rekomandoja të vinin e të qëndronin këtu për ca ditë, më pas, jam e sigurt, do të largoheshin me shumë gjëra për të bërë dhe me shumë energji për të vazhduar përpara. Mendoni botën 100 vjet më parë. Njëqind vjet më parë, bota ishte më e ngadaltë, më pak demokratike dhe dominohej nga shumë pak vende dhe kompani të fuqishme.

Pa shiheni botën sot. Bota e sotme është më e shpejtë, më demokratike, me më shumë të drejta për njeriun dhe lëviz shumë më shpejt sesa më parë. Por, kjo botë që kemi, me të gjitha këto përparime që kemi krijuar, është, sipas meje, një peshë e madhe, sepse nëse je më demokratik, kjo vjen me barrën e rëndë që të vazhdosh të jesh demokratik dhe ta çosh përpara demokracinë. Nëse je shumë më i zhvilluar, ky zhvillim vjen me një barrë për brezin e ri. Ndaj mendoj se, duke evoluar, kemi shtuar zërat në agjendën që po i lëmë mbi shpatulla brezit të ardhshëm.

Megjithatë, mendoj që kjo është shumë e bukur dhe e mirë, sepse, imagjinoni brezin e ri vetëm me komoditetin që kemi krijuar për ta. Sapo të shohin që ky

komoditet lidhet me mungesën e komoditetit në pjesë të tjera të botës, mendoj që ata do t'i kushtojnë vëmendje për ta përmirësuar.

Nëse ky komoditet që iu është krijuar do të preket sikur edhe pak, nëse të drejtat e tyre të njeriut do t'i preket sikur edhe pak, nëse do t'i preket demokracia, jam e sigurt që ata do mendojnë çfarë duhet të bëjnë për t'i mbrojtur. Kështu, jam e sigurt se gjithë kjo botë e hapur ka bërë që brezi i ri të shkojë drejt shtigjeve kërkuese, por njëkohësisht sfiduese, më sfiduese sesa për ne, por do të luajnë rolin e tyre dhe jam e sigurt që janë të mirëpajisur për ta bërë botën më të mirë seç ka qenë. Bota është bërë gjithnjë e më mirë. Ne ankohemi e ankohemi gjithmonë, sepse shohim të ardhmen, po, ndonjëherë, nuk i hedhim sytë nga e shkuara. Po të shohim nga e shkuara, e shohim që është më mirë dhe kjo mund të na ngjallë mjaftueshëm besim te brezi i ri. Në fakt, është një mjedis që mund të ketë agjendën e vet si të ecë përpara e të përmirësohet.

Laila Humairah: Përmendët që jeni për nja dy ditë në Katar. A keni parë këtu ndonjë nismë apo politika, siç e thatë më herët, nga të cilat bota mund të mësojë shumë prej Katarit? Keni ndeshur ndonjë nismë entuziazmuese që ju bën të mendoni se mund të zbatohet si model në Shqipëri?

Linda Rama : E dini? Ajo çfarë më mahnit te vendet e rajonit këtu dhe, sidomos në Katar, është shpejtësia. Kombinimi i shpejtësisë, burimeve dhe vizionit është diçka si të jesh ballë një kompjuteri, të krijosh një formulë dhe ta ndjekësh, që nuk është e lehtë ta bësh. Nëse thua që kjo vjen falë burimeve, burimeve financiare, kjo nuk mjafton, sepse historia na e ka treguar se mund të kesh burime, por, pa vizion, nuk i arrin dot këto realitete.

Nëse nuk i përdor njerëzit mirë, nëse nuk ke përulësi mjaftueshëm dhe nuk i tërheq njerëzit, që edhe ata vetë të shohin rolin e tyre së bashku, për të vepruar në përputhje me një vizion të caktuar, atëherë nuk mund ta bësh këtë që është berë.

Mendoj që këto janë realitetet që na tregojnë çfarë është e mundur dhe çfarë është e pamundur dhe si mund t'i kthesh gjërat në favor dhe për 25 vjet, 30 vjet, 40 vjet, në periudha kohe shumë të shkurtra, të mund të arrish gjëra shumë të

mëdha. Ecja përpara e grave, kombinuar me arsimimin për vajzat këtu dhe mendësia e hapur e burrave dhe grave, duke nisur që nga udhëheqësit, është diçka që realisht më mahnit, më mahnit sepse në konceptin e botës... Unë jam vetë myslimane dhe vij nga gjyshërë që mbanin Ramazan dhe, kur vinte koha e Ramazanit, ose Ramadan siç i thonë në anglisht, ngrihesha në 4 të mëngjesit për të ngrënë syfyre me ta dhe, më pas, kishim iftarin. Që kur isha vajzë e vogël, edhe gjatë komunizmit e bënim këtë, fshehurazi. Zakonisht, bota e krishterë na shihte si të ngadaltë, si dembelë, të pacivilizuar dhe besoj që historia e këtij rajoni ka treguar se kemi një energji të jashtëzakonshme, potencial të jashtëzakonshëm dhe se mund ta bëjmë botën të vrapojë më shpejt sesa kristianizmi i atyre që jetojnë në të shkuarën dhe jo me të ardhmen. Ndaj, kur vij këtu dhe e shoh, ndihem vërtet shumë, shumë mirë. E di që jo gjithçka është e përsosur në këtë realitet të përsosur. Jam e sigurt për këtë. Por, kur shoh shpejtësinë me të cilën arrihen gjërat, jam e sigurt që mund të kuroni edhe ato plagë që vetëm ju e dini ku i keni, me të njëjtën shpejtësi me të cilën keni transformuar realitetin përreth.

Laila Humairah: Dhe me këto fjalë, do doja të më jepnit mendimet dhe komentet e fundit, duke u kthyer te tema e lidërshipt, vendimmarrjes me ndikim dhe vendosjen e njerëzve në qendër të politikëbërjes. Nëse mund të ndani disa mendime të fundit rreth atyre që diskutuam sot.

Linda Rama : Nuk është vetëm kjo. Po, keni të drejtë, vendosja e njerëzve në qendër të vendimmarrjes, por ajo çfarë ka ndryshuar sot është kush janë njerëzit tani? Njerëzit për të cilët fliste lidërshipti i 50 vjetëve më parë, ishin të tjerë njerëz.

Ne nuk jemi të njëjtët njerëz me ata që janë sot. Njerëzit që kemi sot janë me tipare krejt ndryshe, njerëz që shohin jetën në një mënyrë tjetër, që shohin agjendën dhe lidërshiptin e vendit ndryshe . Për shembull, imagjinoj si i formulojnë të rinjtë ambiciet e tyre. Ata duan pension të hershëm, do iu pëlqente të dilnin herët në pension. Duan një ekuilibër më të mirë midis punës dhe jetës. Ne nuk i kishim këto lloj kërkesash. Nëse vije te ne për një punë, për ne ishte e rëndësishme çfarë pune ishte, çfarë të ardhurash do na sillte. Për ta, jam e sigurt që do të thonë, “a mund ta bëjmë këtë punë me orar fleksibël ose në distancë? Ky mund të jetë kriteri i parë për ta. Nuk ka asgjë të keqe këtu, por, si lider, ata, pra liderat tanë, pasi unë vetë nuk kam për të qenë ndonjëherë e tillë në jetë. Unë jam një tjetër lloj lidere. Jam lidere e liderit tim dhe lider e grupit të njerëzve që punojnë me mua. Por lidërshipti duhet të marrë në konsideratë që po merren me

ketë tipologji njerëzish dhe duhet të vendosim në qendër të vendimmarrjes njerëz, të cilët kanë një kombinim perceptimesh dhe kërkesash të ndryshme për jetën. Ajo çfarë shoh shumë të vështirë dhe po aq si sfidë për lidërshtipin janë dy gjëra. Së pari, të dëgjojnë. Është sfidë, pasi iu duhet të dëgjojnë kaq shumë njerëz përreth tyre. Por mendoj se procesi më i rëndësishëm e dëgjimit është ai i njerëzve të thjeshtë. Ata e dinë më mirë se kushdo tjetër çfarë funksionon dhe çfarë nuk funksionon. E dyta, ruajtja e ndjeshmërinë, sepse, për liderat, ngjarjet janë përsëritëse. Po të sëmurem dhe i bie derës së një lideri dhe i them, “jam sëmurë, duhet të kurohem”, ata mund të kenë mijëra raste, sidomos në vende të vogla si i yni, që njerëzit iu thonë jam sëmurë, duhet të kurohem, më gjej një zgjidhje. Dhe ky mund të jetë rasti i njëmijtë dhe të thuash “po të gjithë janë sëmurë”, ndaj mund të të humbë ndjeshmëria, por personi mund të ketë një problem real dhe ka nevojë të gjejë zgjidhje. Pra, ruajtja e ndjeshmërisë sikur të ishte rasti i parë, mendoj që është gjëja më e vështirë për ata që udhëheqin. Ndjeshmëria dhe lidërshtipi nuk shkojnë mirë bashkë, ndaj duhet shumë punë që ta ruash. Tjetra, lidërshtipi, politika duhet të gjejë një mënyrë për të pasur më shumë qëndrueshmëri, sepse, për dy vjet, liderat nuk mund të bëjnë dot asgjë për ambiciet e tyre të mëdha. Në katër vjet, nuk mund të bëjnë dot asgjë për ambiciet e tyre të mëdha. Më kujtohet një studim i imi dy vjet më parë. Po shqyrtoja metodat e financimit për objektivat e zhvillimit në përgjithësi, kur objektivat duhej të realizoheshin, me qëllim që të gjendej financimi. Një prej gjetjeve, pas këqyrjes serisë së të dhënave përgjatë 30 vjetëve, pra menjëherë pas vitit 1990, ishte se kur në vend ndodh një goditje, po themi skemat piramidale që patëm në vitin 1997, duhen 10 vjet për të rikuperuar derisa të ndërtohet besimi, që investuesit e huaj të kthehen. Pra, 10 vjet. Mendojeni, a ka periudhë 10-vjeçare një udhëheqje, që të ketë kohë të presë 10 vjet? Ja pse demokracia dhe këto luhajtje kanë sjellë agjenda shumë të vështira, të cilat kanë ndikim edhe mbi agjendat e zhvillimit në vendet ku jetojmë.

Pra, dëgjimi dhe ndjeshmëria, këto doja të theksoja.

Laila Humairah : Dëgjimi dhe ndjeshmëria. Falemnderit shumë.

Dua tani të jap fjalën për disa pyetje, ndoshta, një ose dy pyetje nga salla, nëse keni për Lindën sot.

Pyetje: Duke qenë se keni përjetuar përvojën e transformimit qeveritar në moshë të hershme, si mund të përshtaten udhëheqësit me çdo luhatje që mund të ndodhë?

Linda Rama : Duke reaguar shpejt, duke u qasur me mendje të hapur dhe jo në kurriz të njerëzve. Është shumë e rëndësishme që çdo vendim që merret të merret nga optika e njerëzve, jo e politikës, jo e pushtetit, sepse ndonjëherë, mund të mos jesh shumë i orientuar pse po e ben këtë zgjedhje. Gjithkush mendon se vendimet që merr janë vendimet e duhura, por të përpiqesh të mbash një mendje të hapur dhe të vendosësh interesat e njerëzve të parat, edhe në kohë të vështira dhe luhatjesh është shumë e rëndësishme. Dhe mos të pretendosh se gjërat mund të zgjidhen në moment. Duhet të jesh vetëm një hallkë e zinxhirit. Nuk mund të jesh i gjithë zinxhiri. Pra, duhet të bësh maksimumin tënd dhe, më tej, duhet të besosh se të tjerët që vijnë pas mund ta bëjnë këtë zinxhir të plotë. Pastaj do të jesh i qetë mjaftueshëm për të marrë vendimin më të mirë të mundshëm për rrethanat ku je. Sigurisht, në kohë të vështira, mund të ketë edhe vendime të gabuara. Askush nuk përjashtohet nga gabimet. Çështja është si të rindërtosh mbi këto gabime, në mënyrë që gabimet të mos përsëriten në historinë e vendit. Sidoqoftë, ndonjëherë, edhe gabimet janë të rëndësishme, për të nxjerrë mësimë më pas për brezat rreth asaj që duhet përmirësuar e asaj çfarë nuk duhet bërë më.

Pyetje: Ahmed Smetir nga Këshilli Kombëtar i Planifikimit . Pyetja ime është, nga përvoja dhe kërkimi juaj, duke pasur parasysh se jeni ekonomiste prej një kohë kaq të gjatë dhe keni një përvojë të mirë, gjatë politikëbërjes dhe vlerësimit të mbështetur në të dhëna dhe propozimit të politikave, gjen shumë njerëz që flasin për përvojën e tyre me organizata globale, si Banka Botërore ose OECD-ja, FMN-ja – ata kanë nga një gamë gjithfarë ekspertësh për të gjitha çështjet – dua të di, nga këndvështrimi juaj, si i vlerësoni cili nga këta shumë konsulentë duhet, po ashtu, si i vlerësoni rezultatet sa i takon propozimit? Siç e përmendët më parë, ka shumë këshillim në dispozicion kur vjen fjala për politikëbërjen. Si e vlerësoni që ky i përshtatet si duhet kontekstit tim?

Dhe pyetja e dytë është kjo: kur vjen fjala për laboratorët e politikave dhe politikëbërjes, cilat janë praktikat më të mira që zbatoni për të dalë në përfundimin se kjo është një politikë për të cilën jam krenare? Ndoshta, mund të na tregoni një politikë, ku keni gabuar dhe pendoheni për të?

Linda Rama: Po, falemnderit. Falemnderit për pyetjet.

Sa iu takon këtyre organizatave, institucioneve të mëdha që janë depozita të kualiteteve shumë të larta dhe konsulencave e ndihmës së shkëlqyer, ajo çka mund t'ju them në aspektin e Shqipërisë, është se jam 100 për qind sigurt se, pa ndihmën e Bankës Botërore, të Bashkimit Evropian, FMN-së dhe të OECD-së, po ashtu, është 100 për qind e sigurt se, pa praninë e vazhdueshme, që nga dita e parë e tranzicionit, të organizatave të Kombeve të Bashkuara dhe agjencive dypalëshe, ne nuk do ia kishim dalë të përballonim atë agjendë kërkuese që shtrihej përpara nesh. Pra, pa këtë ndihmë, nuk do të kishim qenë ku jemi sot, duke trokitur në derën e Bashkimit Evropian dhe të aftë që, brenda një viti, të çelnim kapitujt e bisedimeve për anëtarësim me Bashkimin Evropian – dy ditë më parë, u çel kapitulli i fundit i negociatave.

Përmenda specifikisht organizatat e Kombeve të Bashkuara, sepse agjenda e të drejtave të njeriut, ajo e grave, përfshi të drejtat e grave, të drejtat e fëmijëve, e çështjeve zhvillimore nga këndvështrimi njerëzor, ishte një agjendë shumë e vështirë për t'u zbatuar në vende si i yni. Unë vetë jam një produkt, të themi, i organizatave të Kombeve të Bashkuara. Sot, besoj më shumë se ata te misioni i tyre. Pse? Sepse e di ndikimin që kanë pasur tek unë dhe njerëz si unë. Dhe njerëz si unë janë njerëz nga organizatat shoqërisë civile, që nuk kërkojnë drita dhe skenë. Ata janë të qetë, të heshtur, por punojnë çdo ditë me të gjitha kapacitetet për të ndihmuar qeverinë, për të ndihmuar administratat, për të ndihmuar njerëzit dhe i çojnë gjërat përpara pa bërtitur. Kurrë nuk i kam parë organizatat e Kombeve të Bashkuara të bërtasin në vendin tim, por kanë qenë përherë, në mënyrë konstante, të pranishme aty. Dhe sa herë që sot bëhen diskutime rreth efikasitetit të këtyre organizatave – me efikasitet e kam fjalën për mirëpërdorimin e parave – nuk kam asgjë kundër. Efikasiteti do të jetë gjithnjë problem për organizatat e mëdha, për organizatat qeveritare, ndaj ky është një objektiv dhe duhet të vijojë të jetë. Por, nuk mund të zhdukim agjenda, meqë duam të flasim për pará. Unë refuzoj shuarjen e agjendave që merren me njerëzit, për shkak të parave. Paratë, për mua, vijnë pas. Le të flasim për paratë. Le të flasim si mund ta përmirësojmë efikasitetin dhe t'i bëjmë llogaridhënëse organizatat, por nuk mund të mbylлим organizata, për shkak të këtyre diskutimeve. Unë kështu e shoh nga këndvështrimi im. Mendoj që, ndoshta, këto organizata kanë nevojë të transformohen me të njëjtën shpejtësi që transformohen realitetet, pasi, ndonjëherë, kur hedh sytë drejt tyre, sheh më shumë të shkuarën sesa të ardhmen dhe realiteti për to nuk është njësoj siç ishte

dy dekada më parë. Megjithatë, ne duhet t'i shtyjmë drejt këtij transformimi, qeveritë duhet t'i shtyjnë dhe, njëkohësisht, t'i përdorin në të mirë të tyre.

Tani, cila është politika që, për mua, mund të funksionojë për përfshirjen? Unë kam punuar shumë me decentralizimin e pushtetit vendor, në kuptimin e përmirësimit të shërbimeve dhe vendosjes së shërbimeve më shumë në nivelin lokal, si dhe për t'i bërë njësitë qeverisjes vendore më gjithpërfshirëse dhe mendoj se llogaridhënia dhe gjithpërfshirja janë dy gjëra, dy momente me rëndësi thelbësore në vendimmarrje. Gjetja e të gjitha mënyrave për t'i diskutuar politikat dhe për t'i bërë njerëzit që të kenë interes të japin komentet e tyre mbi çdo vendim që çohet nga komunitetet vendore te qeveria e madhe, është shumë, shumë e rëndësishme. Çfarë nuk ka funksionuar? Shumë gjëra që i kam në listën time, për shembull, nuk janë realizuar ende. Pse? Ka edhe disa qeliza që vazhdoj t'i kem brenda meje që janë të vdekura tashmë. Për shembull, në vitin 1996, isha një nga njerëzit që kam nxitur shumë, në cilësinë e dikujt që ishte në nivelet e larta të administratës publike, krijimin e bursës në Shqipëri. Në vitin 1996, u krijua bursa, Bursa e Tiranës.

Në atë kohë, për mua, ky nuk ishte vetëm një institucion i instrumenteve financiare që mund të ofronte mundësi të reja financimi, por, njëkohësisht, ajo çfarë unë e konsideroja më të rëndësishme ishte që njerëzve t'iu ofrohej një tjetër instrument i edukimit financiar, sepse, në vitin 1996, edukimi financiar në vend thuajse nuk ekzistonte. Gjatë komunizmit, njerëzit nuk ishin aspak të ekspozuar ndaj bankave, ndaj kishin një mënyrë krejt ndryshe për financimin dhe mbajtjen e parave të tyre. Pra, unë e shihja nga ky këndvështrim, po aq sa e shihja si një institucion që mund të ndihmonte për krijimin dhe rritjen e fondeve të pensionit apo të institucioneve të tjera si fondet e investimeve dhe transformimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri aksionare e kështu me radhë. Nuk funksionoi kurrë dhe ca vjet më parë, u mor një vendim nga banka qendrore dhe, nuk di, nga qeveria – nuk e kam as të qartë kush e mori vendimin – që bursa të mbyllej. U mbyll, sepse nuk kryente asnjë transaksion. Në atë moment, ndjeva sikur kishte vdekur një pjesë e imja. Nuk ndodhi për shkakun tim, sigurisht, por kishte vdekur.

A ishte gabim? Aktualisht, koha nuk e mbështet projektin e bursës, sepse kemi një realitet financiar krejt tjetër. Kemi kriptomonedha, kemi pagesa digjitale dhe një realitet krejt ndryshe nga pikëpamja financiare. Sot, bursa nuk ka kuptim, por nuk jam e sigurt nëse supozohej të mos kish kuptim për 20 vjet.

Mendoj se ishte e gabuar që nuk u bënë përpjekje për të dhe gjërat mund të kishin qenë paksa ndryshe, por, sigurisht, është konteksti ai që i imponon vendimet. Vëmendja ndryshon sa këtu-aty dhe mund të mos jetë aty ku je ti dhe, këtë e them për vete, ti mund të mos jesh në pozitën për t'i ndjekur dhe për t'i realizuar të gjitha ëndrrat apo mendimet që ke. Unë nuk kam pasur përherë, nuk kam fuqi vendimmarrjeje. Unë kam aq fuqi vendimmarrjeje sa keni ju, ndoshta më pak, sepse ju mund të jeni vendimmarrës në organizatat tuaja, por, sigurisht, kam bërë dhe të gjithë njerëzit që kanë shërbyer si unë, ata në institute studimore, shoqëria civile, kanë bërë maksimumin për të bërë analiza, për të ndjekur probleme, për të paraqitur gjetje dhe rekomandime, si dhe për të nxitur zbatimin e rekomandimeve duke mobilizuar vendimmarrësit.

Laila Humairah : Me këto fjalë, mendoj që na mbaroi koha. Ju falemnderit shumë të gjithëve që ishit këtë mëngjes me ne. Falemnderit Linda që ishte me ne, që ndave të gjitha mendimet e tua mbi lidshiptin dhe shpresoj se, qoftë në Katar apo Shqipëri, do të kemi krijuar brezin tjetër dhe pas 10, 20 vjetësh, do të shohim frytet e farave që janë mbjellë sot te gjithkush. Falemnderit shumë.

Linda Rama : Falemnderit, Laila, falemnderit. Ma bëre edhe më të lehtë bisedën.

Laila Humairah: Falemnderit shumë.

Linda Rama: Falemnderit.

Laila Humairah: Në emër të QSC-së dhe Shoqatës së të Diplomuarve, dua t'ju falënderoj që erdhët dhe ndatë njohuritë dhe historitë tuaja të suksesshme e kuptimplota. Do të dëshironim t'ju jepnim këtë dhuratë të vogël si kujtim.

Linda Rama : Ju falemnderit. Do të thotë shumë për mua. Falemnderit shumë. E shijova vërtetë praninë dhe bisedën këtu.

Thonë që pas çdo burri të madh, qëndron një grua e madhe, kështu që nuk shqetësohemi aspak për suksesin e bashkëshortit tuaj.

Linda Rama: Nuk qëndroj pas. Jam përkrah tij, përkrah, vetëm një hap pas, duke e lënë Edin përpara. Faleminderit shumë.